



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 35

Prishtinë, më 18.07.2018, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N/204

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Hajdar Beqa, Frashër Krasniqi, Arben Gashi, Korab Sejdiu, Nezir Çoçaj, Shkumbin Demaliaj dhe Bilall Sherifi;

Munguan: Albulena Haxhiu, Bahrim Shabani, Sami Kurteshi dhe Igor Simiç;

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Bekim Kodraliu OSCE, Blerta Bejtullahu EUSR/EUO, Adem Gashi Amb.Amerikane, Fitore Sopjani- Praktikante KRK, Donika Osmani RTV 21, Besjana Bajrami EO, Rreze Hoxha GLPS, Paris Guri KDI, Edita Kusari EUSR/EUO, Berita Abazi VV, Lumnije Berisha OSCE, Rina Beka NDI.

Mbledhjen e kryesoi, Hajdar Beqa- Nënkyetar i komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur me datë 21.05.2018;
3. Shqyrtimi i Raporteve të Komisioneve Kryesore për Projekt-Rregulloren e Kuvendit;
4. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL për Projektligjin nr.06/L-022 për Ndërmarrjet Sociale;
5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL për Projektligjin nr.06/L-035 për Veprimtaritë Hidrometeorologjike;
6. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për ndryshimin dhe plotesimin e Ligjit nr.04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës;

7. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Hadar Beqa- propozoi që pika katër të hiqet nga rendi i ditës, pasi që vlerësonte se duhet të analizohet më shumë, sidomos pjesa e sanksioneve duhet të harmonizohet me Ligjin për Kundërvajtje, tha z. Beqa.

Rendi i ditës u miratua me ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur me datë 21.05.2018;

Z.Beqa,konstatoi se komisioni miratoi pa vërejtje procesverbalin nga mbledhja e mbajtur me datë 21.05.2018.

3. Shqyrtimi i Raporteve të Komisioneve Kryesore për Projekt-Rregulloren e Kuvendit;

Hajdar Beqa- tha se Komisionet Kryesore kanë shqyrtuar raportin me amendamente, ai shtoi duke thene se Komisioni për Integritet ka propozuar tetë amendamente, ndërsa Komisioni për Buxhet dhe Financa në mbledhjen e mbajtur me datën 04.07.2018 ka vlerësuar se Projekt-Rregullorja dhe amendamentet e propozuara nuk përbëjnë implikime buxhetore shtesë, gjithashtu Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve në mbledhjen e datës 04.07.2018 ka vlerësuar se Projekt-Rregullorja dhe amendamentet e propozuara nuk i cenon dhe nuk i prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve. Deputeti Beqa, tha se amendamentet e Komisionit për Integritet Evropian duhet të përkrahen në pako sepse vetëm sa e qartësojnë kapitullin XV ku flitet për bashkëpunim ndërmjet Kuvendit dhe Qeverisë për çështjet e integriteteve evropiane.

Arben Gashi- tha, mospjesëmarrja në votim është çështje politike dhe derisa të kemi një vendim tjetër do të veprojmë në këtë mënyrë. Ndërsa për amendamentet e propozuara nga Komisioni për Integritet Evropian, ai tha se nuk kanë të bëjnë me ndryshim në esencë duke dhënë arsyetim se edhe pa to Rregullorja ka qenë me atë pjesë në rregull. Ndërsa sa i përket çështjes së parë të caktimit të orarit për votim, ai tha se do të ishte shumë praktike edhe për Kuvendin tonë. Më pas shtoi se rregullat që vlejné për seancën e Kuvendit, vlejné edhe për komisione, pra përderisa duhet kuorum për fillim të seancës së Kuvendit atëherë duhet kuorum edhe për fillim të seancës së komisionit.

Bilall Sherifi-tha se nëse Rregullorja shkon në lexim të dytë nuk ka më afat për amendamente. Duhet të përfshihet në Rregullore çështja e votimit, jo të votohet pas çdo debati të një ligji apo të një çështje. Është mire që edhe seanca të ndjek një shembull siç është në disa vende të Bashkimit Evropian, ku seancat mund të fillojnë edhe pa kuorum por jo edhe votimi. Esenca e kuorumit mbetet tek votimi por jo tek fillimi i punëve të trupave të Kuvendit dhe të seancës theksoi deputeti Bilall Sherifi.

Shkumbin Demaliaj- theksoi duke thënë se AAK-ja është kundër kësaj që të vendoset pa kuorum të filloj mbledhja, sepse deputetët kanë përgjegjësi para qytetarëve.

Hajdar Beqa- tha që Rregullorja duhet të ketë konsensus që të kalojë sepse do të duhen 80 vota. Konsideroj që në grup punues por edhe në komision është arritur një konsensus, besoj që ky konsensus do të ketë edhe në seancë plenare theksoi deputeti Hajdar Beqa.

Z.Beqa konstatoi se në mungesë të kourumit për votim ndërpritet mbledhja e Komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 13:24

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Nënkryetari i Komisionit,

Hajdar Beqa